



Raport hulumtues

KAPACITETET LOKALE PËRBALLË KLIMËS

Gati për ndryshim apo të papërgatitur?

Autorët:

Andi Batusha
Skënder Perteshi

Qershor 2025 – Prishtinë

Pikat e shprehura dhe opinionet janë ato të autorit/autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur - Ballkani Perëndimor.

Rreth institutit PREVENT

I themeluar në vitin 2024, Instituti për Siguri dhe Reziliencë - PREVENT synon një Kosovë ku siguria, stabiliteti dhe sundimi i ligjit ruhen përmes qasjeve inovative dhe bashkëpunuese. Duke promovuar reziliencën dhe gjithëpërfshirjen, PREVENT përpaket të krijojë një shoqëri ku individët, komunitetet dhe institucionet punojnë së bashku për të trajtuar sfidat komplekse të sigurisë. Misioni i PREVENT është të ndërtojë komunitete të qëndrueshme duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe ekspertizë në zhvillimin e politikave publike, avokim dhe zbatim të projekteve.

PREVENT fokusohet në fuqizimin e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të rinjve, përmes hulumtimeve të bazuara në të dhëna, nismave për ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke luftuar aktivisht ekstremizmin e dhunshëm.

Prishtinë, Qershor 2025

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme, mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen e shkruar të botuesit. Shfrytëzimi komercial i materialeve të botuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT nuk lejohet pa lejen e shkruar.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Metodologjia e Hulumtimit	5
Përshkrimi i kontekstit lokal në raport me ndryshimet klimatike	6
1. Analizë e kërcënimeve dhe rreziqeve nga ndryshimet klimatike në nivelin lokal	8
1.1 Zjarret në pyje dhe sipërfaqe të hapura	8
1.2 Menaxhimi i lumenjve dhe liqeneve në Kosovë Sfida dhe mungesa e koordinimit institucional	10
1.3 Shirat e rrëmbyeshëm dhe sistemi i ujërave të zeza; Sfida për komunat në Kosovë	12
1.4 Menaxhimi i mbeturinave dhe sfidat në nivel lokal në Kosovë	14
2. Vlerësimi i kapaciteteve lokale për përballje me ndryshimet klimatike në komunat e Kosovës	15
3. Perceptime Lokale për Ndryshimet Klimatike	19
3.1 Vetëdija, njohuritë dhe përgatitja e qytetarëve	19
3.2 Ndikimet e perceptuara klimatike	20
3.3 Boshllëqet në informim dhe sjellje	21
Përfundimi	25
Rekomandimet	27

Hyrje

Ndryshimet klimatike nuk po ndryshojnë vetëm ekosistemet, por gjithnjë e më shumë po njihen si kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj stabilitetit ekonomik, shëndetit publik dhe sigurisë kombëtare. Në Kosovë, ky kërcënim përkeqësohet nga boshllëqet institucionale, vetëdija e kufizuar publike dhe mungesa e kapaciteteve të duhura profesionale e logjistike në nivel lokal për tu përballur me këtë fenomen. Edhe pse adresimi i çështjeve të klimës dhe sigurisë në Kosovë e botë ende rregullohet nga niveli qendror tek ai lokal, suksesi i përpjekjeve për tu përballur mirë me ndryshimet e klimës varet nga përgatitja nga poshtë-lart – veçanërisht nga qeveritë lokale, shoqëria civile dhe vetë qytetarët, si reaguesit e parë ndaj këtij fenomeni.

Kosova tashmë po përjeton pasojat e paqëndrueshmërisë klimatike: thatësira më të shpeshta verore, përmbytje, valë të të nxehtit dhe degradim të tokës. Raporti për Klimën dhe Zhvillimin i Bankës Botërore për vitin 2024 vlerëson se Kosova duhet të investojë së paku 2.8 miliardë euro gjatë dekadës së ardhshme për të adresuar në mënyrë efektive këto rreziqe në rritje. Megjithatë, investimet financiare nuk mjaftojnë pa një rritje të njëkohshme të kapaciteteve institucionale, vetëdijes qytetare dhe angazhimit publik në këtë drejtim. Një pjesë e madhe e këtyre investimeve duhet të shkojnë në forcimin e kapaciteteve të nivelit lokal për tu përballur me këtë fenomen.

Gjetjet nga raporti i Institutit PREVENT i vitit 2025, **"Kosova në Front me Pasojat e Ndryshimit të Klimës"**¹, treguan se 70% e komunave të anketuara nuk posedonin as instrumentet më themelore ligjore, si strategjitë për reduktim të rrezikut apo kornizat për reagim emergjent. Megjithëse janë në vijën e parë të menaxhimit të krizave dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët, shumica e qeverive lokale nuk janë të pajisura siç duhet, as ligjërisht si dhe në nivel operacional, për të përballuar fatkeqësitë e shkaktuara si pasojë e ndryshimeve të klimës. Shumica e komunave në nivel të Kosovës nuk i kanë të hartuara planet lokale për reagim emergjent apo planet për reduktimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë tjera. Për më shumë, shumica e komunave nu i kanë as kapacitetet njerëzore e profesionale për të hartuar dokumente kualitative për të menaxhuar me mirë kërcënimet dhe rreziqet që shkaktohen nga fatkeqësitë natyrore apo si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Tutje, raporti thekson se komunat dhe mekanizmat tjerë në nivel lokal, si sektori i biznesit, sektori jo-qeveritar, shkollat, fshatrat dhe këshillat lokal, fermerët, si dhe komuniteti në përgjithësi nuk i kuptojnë pasojat reale të ndryshimeve klimatike në

¹ **Instituti PREVENT.** (2025). *Kosova në front me pasojat e ndryshimit të klimës: Gjetje nga diskutimet në fokus grupe në pesë komuna.*

fushën e sigurisë, si dhe jetën e përditshme të tyre. Niveli lokal nuk ka arritur që të ndërtojë strukturë reaguese, duke përfshirë edhe komunitetin, që të përballët sa më lehtë në menaxhimin e pasojave dhe kërcënimeve që kanosen si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Ky raport hulumtues ofron një pasqyrë rreth perceptimit publik dhe njohurive institucionale lokale rreth ndryshimeve klimatike dhe sigurisë. Përmes fokus grupeve të organizuara në komunat: Rahovec, Prizren, Viti dhe Suharekë, ne vlerësojmë se si zyrtarët komunal dhe qytetarët i kuptojnë, i përfshijnë dhe i përparësojnë rreziqet klimatike. Qëllimi i këtij hulumtimi është të informojë politikat dhe ndërhyrjet programore rreth ndryshimeve klimatike dhe sigurisë, me njohuri konkrete nga vetë komunitetet më të prekura nga ky fenomen..

Siç theksohet në **Vlerësimin e Ndikimit të Klimës dhe Sigurisë nga NATO (2024)**², qeverisja lokale është shtresa e parë e mbrojtjes ndaj rreziqeve klimatike që përhapen zinxhir, por njëkohësisht edhe më e cenueshmja kur ka mungesë burimesh për trajtimin e rreziqeve dhe kërcënimeve klimatike. Në Kosovë, forcimi i kësaj qëndrueshmërie lokale kërkon një kuptim të qartë të niveleve të vetëdijes publike dhe kapaciteteve institucionale reaguese në terren.

Metodologjia e Hulumtimit

Për hartimin e këtij raporti hulumtues është përdorur një kombinim metodash cilësore dhe analizash, me qëllim të sigurimit të një pasqyre të plotë dhe të detajuar mbi sfidat dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike në nivel lokal.

Mbledhja e të dhënave kryesore u realizua kryesisht përmes organizimit të fokus grupeve në nivel lokal, në komunat pjesëmarrëse në projekt: Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Viti dhe Fushë Kosovë. Çdo fokus grup përbëhej nga përfaqësues kyç të komunitetit dhe institucioneve lokale, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në trajtimin dhe menaxhimin e sfidave të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Pjesëmarrësit përfshinin përfaqësues nga drejtoria e bujqësisë, shërbimeve publike, agjencitë për menaxhim emergjent (niveli lokal), inspektorate, organizata joqeveritare, fermerë, komunitete lokale, policia si dhe mekanizma të tjerë të rëndësishëm në nivel lokal.

Analiza poashtu përfshiu shqyrtimin e legjislacionit vendor dhe strategjive shtetërore që trajtojnë pasojat e ndryshimeve klimatike dhe sigurinë mjedisore. Kjo analizë

² **Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut – NATO.** (2024). *Vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve klimatike në siguri: Raste dhe rekomandime për Ballkanin Perëndimor*

kishte për qëllim të identifikojë kuadrin ligjor dhe politikat ekzistuese, si dhe të evidentojë boshllëqet apo sfidat në zbatimin e tyre.

Vlerësimi i raporteve hulumtuese të mëparshme nga institucione shtetërore, organizata lokale dhe ndërkombëtare përbënte një komponent thelbësor të këtij raporti. Kjo qasje mundësoi përdorimin e të dhënave dhe njohurive ekzistuese për të pasuruar kuptimin e çështjeve të trajtuara dhe për të vendosur gjetjet e hulumtimit në një kontekst më të gjerë.

Për hartimin e këtij raporti janë realizuar vizita observuese në komunat cak të këtij hulumtimi, me qëllim të plotësimit të të dhënave dhe verifikimit të situatës në terren. Këto vizita ndihmuan në identifikimin e praktikave lokale, sfidave konkrete dhe nevojave emergjente lidhur me ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në komunitete. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet fokus grupeve, analizave dokumenteve zyrtare dhe legjislacionit dhe raporteve të tjera dhe vizitave observuese kanë qenë kyçe për hartimin e këtij raporti hulumtues e vlerësues.

Kjo metodologji e kombinuar siguron që raporti të pasqyrojë jo vetëm perspektivat dhe përvojat e aktorëve lokalë, por edhe një kuadër të gjerë institucional dhe ligjor, duke kontribuar në krijimin e një baze të fortë për rekomandime dhe politika efektive në fushën e ndryshimeve klimatike dhe sigurisë në Kosovë.

Përshkrimi i kontekstit lokal në raport me ndryshimet klimatike

Kosova po cilësohet gjithnjë e më shumë si një nga vendet më të cenueshme ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor. Vendi po përballet me rritje të ndjeshme të temperaturave mesatare, ndryshime në modelet sezonale të reshjeve dhe shtim të dukshëm të ngjarjeve ekstreme klimatike, si përmbytjet, thatësitrat, zjarret në pyje, erërat e forta dhe reshjet intensive. Këto dukuri kanë pasoja të drejtpërdrejta në jetën e përditshme të qytetarëve, duke cenuar sigurinë publike, ekonominë vendore dhe mjedisin jetësor. Dëmet më të mëdha ndodhin në sektorët e bujqësisë, infrastrukturës dhe shëndetit publik. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, Kosova ka nevojë për rreth 2.8 miliardë euro investime gjatë dekadës së ardhshme për të përballuar ndikimet klimatike dhe për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe mbrojtës ndaj krizave që lidhen me klimën.

Një prej faktorëve kyç që kontribuon në përkeqësimin e situatës klimatike është varësia e lartë e Kosovës nga burimet fosile të energjisë, sidomos termocentralet me qymyr, të cilat janë përgjegjëse për rreth 87% të emetimeve të gazeve serrë në nivel

kombëtar. Kjo jo vetëm që ndikon negativisht në ambientin dhe shëndetin publik, por gjithashtu rritë ekspozimin e Kosovës ndaj presioneve ndërkombëtare për dekarbonizim dhe ndaj pasojave ekonomike nga rregulloret e reja për tregtimin e karbonit në nivel ndërkombëtar. Ndërkohë, pjesa më e madhe e investimeve klimatike pritet të ndodhë në nivel lokal, duke qenë se komunat dhe komunitetet janë në vijën e parë të përballjes me pasojat e ndryshimeve klimatike. Për këtë arsye, ndërtimi i kapaciteteve profesionale dhe logjistike në nivel lokal dhe përfshirja aktive e qytetarëve në këtë proces janë thelbësore për suksesin afatgjatë të politikave klimatike dhe të sigurisë në Kosovë.

Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2027³ e trajton ndryshimin klimatik si një kërcënim serioz dhe të pakufizuar, që ndikon në sektorë të ndjeshëm si bujqësia, furnizimi me ujë, shëndeti publik dhe siguria. Dokumenti strategjik kërkon zhvillimin e mekanizmave për gatishmëri emergjente, përforsimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe ndërtimin e një kapaciteti gjithëpërfshirës për menaxhimin e krizave klimatike në të gjitha nivelet e qeverisjes. Megjithatë, situata në terren tregon për mungesë të theksuar të koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, për ndarje të paqarta të përgjegjësisë dhe përfshirje të pamjaftueshme të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes dhe ndarjes së burimeve.

Niveli lokal përballlet me sfida serioze që e kufizojnë aftësinë për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe efektive ndaj krizave klimatike. Mungesa e kapaciteteve teknike dhe profesionale për hartimin dhe zbatimin e politikave klimatike është ndër problemet më të mëdha të nivelit lokal. Po ashtu, mungesa e financimit të qëndrueshëm, e pajisjeve për menaxhimin e emergjencave, mungesa e infrastrukturës për paralajmërim të hershëm, si dhe shpesh mungesa e vullnetit politik dhe bashkëpunimit ndër-institucional, e dobësojnë ndjeshëm reagimin lokal ndaj kërcënimeve klimatike. Këtyre sfidave u shtohen edhe problematika mjedisore si ndotja e lumenjve, menaxhimi joefikas i mbeturinave, ndërtimet pa leje, shkatërrimi i pyjeve dhe i zonave të gjelbra, si dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i tokës bujqësore. Për më tepër, vetëdija qytetare për rëndësinë e çështjeve klimatike mbetet e ulët dhe pjesëmarrja publike në ruajtjen e mjedisit është ende e fragmentuar.

³ **Zyra e Kryeministrit.** (2022). *Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2027*.

1. Analizë e kërcënimeve dhe rreziqeve nga ndryshimet klimatike në nivelin lokal

Të dhënat e mbledhura gjatë takimeve dhe fokus grupeve të mbajtura në komunën e Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Vitisë, dhe Fushë Kosovës të mbajtura gjatë muajve Prill dhe Maj 2025, dëshmojnë qartë për rritjen e frekuencës dhe intensitetit të pasojave rreziqeve dhe kërcënimeve të lidhura me ndryshimet klimatike. Disa prej kërcënimeve kryesore që u identifikuan janë zjarret, rritja e temperaturave të larta për një kohë të gjatë, reshjet e dendura, vërshimet, erërat e forta, si dhe ndotja e ajrit, përveç tjerave. Përveç sfidave natyrore që pasojat e të cilave po rriten si rezultat i ndryshimeve klimatike, niveli lokal po përballët edhe me një numër të madhe të sfidave dhe kërcënimeve të cilat po shkaktohen qoftë prej faktorit njeri, apo prej punës jo të duhura apo neglizhencës qytetare, e të cilat po kanë pasojat të mëdha për qytetarët e pronën dhe të cilat po rriten edhe më shumë si rezultat i ndryshimeve të klimës. Disa nga kërcënimet të cilat shkaktohen nga faktori njeri apo nga mos puna e duhur e institucioneve në nivel qendror e lokal janë: zjarrënia e qëllimshme apo djegja e hamullorëve, menaxhimi apo trajtimi jo i duhur i shtratit të lumenjve, shkatërrimi i pyjeve dhe tokës bujqësore, ngulfatja e infrastrukturës ujore dhe sistemit të ujërave të zeza, si rezultat i rritjes së ndërtimeve në zonat urbane, lëshimi i lejeve të ndërtimit duke mos marrë për bazë kriteret dhe standardet e rreziqeve që mund të vijnë nga ndryshimet e klimës. Mungesa e koordinimit mes nivelit lokal dhe qendror, si dhe mungesa e kapaciteteve inspektuese poashtu paraqet një sfidë tjetër të madhe për trajtimin dhe menaxhimin e këtyre sfidave. Kërcënimt dhe rreziqet me të cilat janë përballur 5 komunat që kanë qenë pjesë e projektit, po ballafaqohen shumica e komunave të Kosovës, të cilat kanë sfidat e njëjta për trajtimin dhe menaxhimin e pasojave të kërcënimeve dhe rreziqeve që vijnë si rezultat i ndryshimeve të klimës.

Zjarret në sipërfaqe të hapura

Zjarret në sipërfaqe të hapura, qofshin ato në zona malore apo fushore, përbëjnë një nga rreziqet më serioze dhe të përsëritura me të cilat përballen pothuajse të gjitha komunat e Kosovës. Këto zjarre, që tradicionalisht kanë qenë të përqendruara gjatë muajve të verës – kryesisht në korrik dhe gusht, periudha kur temperaturat arrijnë nivelet më të larta – po shfaqen gjithnjë e më shpesh edhe gjatë stinëve të pranverës dhe dimrit. Ky fenomen është intensifikuar ndjeshëm si pasojë e ndryshimeve klimatike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e temperaturave mesatare sezonale dhe në krijimin e kushteve të favorshme për shpërthimin dhe përhapjen e zjarreve.

Shembuj konkretë nga komunat e Kosovës e dëshmojnë qartë këtë situatë alarmante. Vetëm në Komunën e Vitisë, gjatë katër muajve të parë të vitit 2025, janë

regjistruar mbi 100 raste të zjarreve në hapësira të hapura – një shifër tejet e lartë, sidomos duke pasur parasysh që kjo periudhë përkon me muajt më të freskët të vitit. Shumica e këtyre zjarreve janë shkaktuar nga djegia e hamullorëve dhe mbetjeve bujqësore nga qytetarë dhe fermerë të papërgjegjshëm, si dhe nga qytetarët që kanë organizuar piknik në natyrë. Megjithatë, rritja e temperaturave përtej mesatares sezonale ka bërë që këto zjarre të përhapen me shpejtësi dhe të dalin jashtë kontrollit.

Me një situatë të ngjashme kanë përjetuar edhe komunat e Suharekës dhe Rahovecit, ku janë raportuar gjithashtu mbi 200 raste të zjarreve – kryesisht si pasojë e djegies së mbetjeve bujqësore dhe moszbatimit të standardeve për menaxhimin e tokës pas korrjeve. Në të gjitha këto raste, shërbimet komunale të zjarrfikjes janë përballur me vështirësi të mëdha për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknike dhe njerëzore reaguese që posedojnë, terrenit të vështirë për ndërhyrje, mungesës së sistemeve të paralajmërimit të hershëm, si dhe koordinimit të dobët ndërinstitucional.

Kjo situatë nuk është e kufizuar vetëm në këto tri komuna, por përbën një sfidë të përbashkët për të gjithë territorin e Kosovës. Komunat si Malisheva, Gjakova, Kamenica, Shtimja, Skenderaj, Peja, Klina, Prizreni dhe Mitrovica gjithashtu kanë raportuar rritje të konsiderueshme të rasteve të zjarreve, veçanërisht në zonat me sipërfaqe të mëdha pyjore dhe kullota, ku ndërhyrja e ekipeve reaguese është më e vështirë dhe ku dëmet që shkaktohen në biodiversitet, pasuritë pyjore dhe tokat bujqësore janë të mëdha. Mungesa e ndëshkimeve efektive për shkelësit, si dhe mungesa e planeve konkrete për menaxhimin e rrezikut në nivel komunal, e kanë thelluar më tej këtë problem. Zjarret shpesh rrezikojnë edhe banesat, infrastrukturën publike dhe jetën e qytetarëve, duke i vendosur në rrezik komunitetet që jetojnë pranë zonave të gjelbra ose në fshatra të thella.

Ky fenomen kërkon një përgjigje urgjente nga të gjitha institucionet përkatëse, duke filluar nga përmirësimi i legjislacionit komunal dhe zbatimi i tij, forcimi i kapaciteteve të njësive të mbrojtjes nga zjarri, rritja e bashkëpunimit me Agjencinë për Menaxhim Emergjent dhe Agjencinë e Pyjeve, e deri tek edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për rreziqet dhe pasojat e zjarreve. Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar në nivel lokal dhe qendror mund të ndalojë përshkallëzimin e këtij fenomeni dhe të sigurojë mbrojtjen e mjedisit, tokës bujqësore dhe jetës së qytetarëve në Kosovë.

Zjarret në sipërfaqe të hapura, veçanërisht gjatë stinëve të pranverës dhe verës, po kontribuojnë në shkatërrimin e florës dhe faunës vendore, në ndotjen e ajrit dhe

tokës, si dhe në përkeqësimin e kushteve klimatike lokale. Në shumë raste, zjarrvëniet janë pasojë e praktikave të vjetruara dhe të gabuara, ku fermerët dhe pronarët e tokave ende besojnë se djegia e hamullorëve dhe mbeturinave organike përmirëson cilësinë e tokës bujqësore dhe rrit rendimentin bujqësor. Kjo bindje, e bazuar në traditë dhe jo në dije shkencore, është dëshmuar si e dëmshme dhe e rrezikshme.

Mungesa e vetëdijes për pasojat afatgjata të zjarrvënieve, e kombinuar me mungesën e masave efektive ndëshkuese, po ndikon në rritjen e veprime e të tilla nga qytetarët dhe fermerët. Institucionet përgjegjëse, si komunat, Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Pyjeve dhe Agjencia për Emergjencë, ende nuk kanë ndërtuar një mekanizëm efikas për identifikimin, ndjekjen penale dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për zjarrvënie – qoftë të qëllimshme apo nga pakujdesia. Mungesa e inspektorëve në terren, koordinimi i dobët institucional dhe mungesa e planeve të qarta të reagimit kanë ndikuar që zjarret të përhapen lirshëm dhe të bëhen të pakontrollueshme.

Menaxhimi i lumenjve dhe liqeneve në Kosovë – sfida dhe mungesa e koordinimit institucional

Menaxhimi i përgjithshëm i lumenjve dhe liqeneve në Kosovë, përfshirë mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtratit të lumenjve, si dhe ndërhyrjet e tjera për menaxhimin e tyre tërësor, është përgjegjësi ligjore e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, ngaqë i gjithë spektri ujor i vendit udhëhiqet nga Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore në kuadër të minsitrisë. Edhe pse lumenjtë ndodhen brenda territoreve të komunave, këto të fundit nuk kanë mandat ligjor për të ndërhyrë apo për të kryer veprime konkrete në menaxhimin e tyre.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga diskutimet e organizuara në komunat e Suharekës, Rahovecit, Prizrenit dhe Vitisë, është evidentuar një problematikë e vazhdueshme: komunat shpesh i janë drejtuar nivelit qendror – konkretisht Ministrisë së Ambientit – për të kërkuar ndërhyrje në pastrimin dhe mirëmbajtjen e lumenjve, me qëllim parandalimin e përmytjeve të shkaktuara nga reshjet intensive. Megjithatë, pjesëmarrësit në grupet fokale kanë raportuar se nuk kanë marrë përgjigje apo mbështetje institucionale në kohë.

Për pasojë, në mungesë të përgjigjes nga niveli qendror, komunat janë detyruar të ndërmarrin veprime vetanake dhe pa autorizim përkatës për të ndërhyrë në lumenjtë që ndodhen në territorin e tyre. Këto ndërhyrje janë bërë kryesisht për të

parandaluar përmbytje që përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë për jetën dhe pronën e qytetarëve.

Një shembull i tillë është Komuna e Vitisë, e cila në vitin 2015 realizoi një investim të rëndësishëm për pastrimin dhe sistemimin e lumit Morava, për të parandaluar përmbytjet. Ky investim u bë pa ndonjë mbështetje nga niveli qendror dhe përfaqëson një shembull të qartë të reagimit proaktiv në mbrojtje të sigurisë mjedisore dhe publike. Megjithatë, që nga ajo kohë nuk është realizuar asnjë ndërhyrje sistematike, as nga komuna dhe as nga institucionet qendrore. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së reagimit dhe koordinimit institucional, si dhe të mbështetjes nga Ministria kompetente.

Zyrtarët lokalë kanë shprehur shqetësimin se përrockat që derdhen në lumin Morava po bllokohen me mbetje, rrëra, vegjetacion dhe materiale të tjera të ngurta, duke rritur rrezikun e përmbytjeve, veçanërisht gjatë stinës së reshjeve të dendura. Në shumë raste, përrockat që vijnë nga territori i Komunës së Gjilanit nuk janë mirëmbajtur, duke shkaktuar probleme të ndjeshme jo vetëm për Vitinë, por edhe për komunat fqinje, si Klllokoti. Kjo situatë vjen si pasojë e mungesës së koordinimit ndërkomunal dhe papërgjegjësisë institucionale.

Një rast tjetër i ngjashëm është ai i Komunës së Suharekës, e cila ka ndërmarrë një sërë iniciativash konkrete dhe të vetëfinancuara për të adresuar sfidat e menaxhimit të lumenjve dhe përballimin e ndryshimeve klimatike. Komuna ka ndërhyrë në shtratin e lumit në fshatin Leshan, duke zgjeruar atë për të parandaluar përmbytjet sezonale, si dhe në kanalin e shkarkimit në Dubiqak, që konsiderohet një ndërhyrje kritike për mbrojtjen e qendrës së qytetit. Megjithatë, këto ndërhyrje janë bërë pa miratim të Ministrisë për shkak të vonesave burokratike dhe nevojës emergjente për reagim.

Situata të tilla janë të përhapura në shumë komuna të Kosovës, të cilat përballen me përmbytje të shpeshta si rezultat i mungesës së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së lumenjve. Këto raste dëshmojnë për një hendek të theksuar ndërmjet përgjegjësisë ligjore të nivelit qendror dhe nevojave të menjëhershme të komunave për të ndërhyrë në raste emergjente.

Për më tepër, një sfidë tjetër e rëndësishme për nivelin lokal është hedhja e mbeturinave urbane dhe materialeve inerte ndërtimore në shtretërit e lumenjve dhe zonat përreth tyre. Ky fenomen, që është përhapur dukshëm vitet e fundit, jo vetëm që ndot mjedisin dhe dëmton ekosistemet ujore, por rrit ndjeshëm rrezikun nga përmbytjet. Mbeturina të forta, si beton, gurë, hekur, tulla apo mbetje druri, të hedhura nga qytetarë apo kompani ndërtimi, bllokojnë rrjedhën natyrore të ujit, duke

reduktuar kapacitetin e lumenjve për të përthithur dhe përçuar ujin gjatë reshjeve intensive.

Mungesa e një sistemi efektiv të monitorimit, numri i kufizuar i inspektorëve komunalë dhe ndëshkimet e papërshtatshme për shkelësit, e bëjnë këtë problem të vazhdojë i pandalshëm. Komunat shpesh gjenden të pafuqishme për të reaguar me kohë, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe teknike për pastrimin e lumenjve.

Në këtë kontekst, harmonizimi i përgjegjësiive ndërmjet nivelit lokal dhe qendror, ndarja e qartë e kompetencave, decentralizimi i fondeve dhe ngritja e kapaciteteve institucionale janë elemente kyçe për përmirësimin e menaxhimit të lumenjve dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet.

Shirat e rrëmbyeshëm dhe sistemi i ujërave të zeza **Sfida për komunat në Kosovë**

Ndryshimet klimatike po reflektohen me intensitet të shtuar në nivel lokal në Kosovë, ku komunat si Vitia, Rahoveci, Prizreni, Fushë Kosova dhe Suhareka po përballen me rreziqe të shtuara nga reshjet intensive dhe përmbytjet. Nga vlerësimet në terren dhe konsultimet me zyrtarë komunalë dhe përfaqësues të komunitetit, rezulton se shirat e rrëmbyeshëm janë bërë më të shpeshtë, më të fortë dhe po shkaktojnë dëme serioze në jetën e qytetarëve, infrastrukturë, bujqësi dhe në ambientin urban.

Në komunën e Vitisë, përmbytjet ndodhin kryesisht për shkak të mungesës së sistemit të ujërave atmosferikë dhe të zeza, si dhe për shkak të ndotjes së lumenjve me mbeturina ndërtimore dhe plastike. Shtrati i lumit Morava, në veçanti, është i bllokuar nga mbetje të ngurta, duke ulur ndjeshëm kapacitetin e përthithjes së ujërave gjatë reshjeve. Komuna përballlet me mungesë të mjeteve financiare dhe kapaciteteve teknike për mirëmbajtje, ndërkohë që mungesa e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe mungesa e një strategjie afatgjate e bëjnë reagimin e saj të kufizuar dhe të pamjaftueshëm.

Sistemet ekzistuese të kanalizimit në Viti janë të dëmtuara, të tejkaluara nga volumet aktuale të ujërave dhe të pamjaftueshme për të përballuar reshjet intensive. Ndërhyrjet e deritanishme kanë qenë të pjesshme. Hedhja e paligjshme e mbeturinave nëpër kanale nga qytetarët dhe subjektet ndërtimore vazhdon të jetë e pandëshkuar, duke përkeqësuar më tej gjendjen. Urbanizimi i shpejtë, migrimi i popullsisë nga zonat rurale në qytete dhe ndërtimi i pandalur i ndërtesave të larta

kanë tejkaluar kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese të ujërave të zeza në shumicën komunave të Kosovës.

Kjo situatë nuk është e izoluar. Edhe komuna të tjera, përfshirë Rahovecin dhe Suharekën, e Prizrenin, po përballen me sfida të ngjashme. Në Rahovec, reshjet intensive të prillit 2024 shkaktuan përmytje të menjëhershme në zonat urbane dhe dëme të mëdha në bujqësi, përfshirë qindra hektarë me vreshta dhe pemishte. Shkaktarët kryesorë ishin bllokimi i kanalizimeve nga mbeturinat dhe mungesa e pastrimit të rregullt. Po ashtu, ngricat e papritura në fillim të prillit shkaktuan dëme të konsiderueshme në prodhimin bujqësor, veçanërisht tek pemët e hershme si qershitë dhe kumbullat.

Në zonat rurale të Rahovecit, fshatrat si Ratkoci dhe Fortesa, kanalet janë të pa mirëmbajtura dhe të ekspozuara ndaj deponive ilegale pranë përroskave, të cilat shtojnë rrezikun e përmytjeve dhe kërcënojnë shëndetin publik. Edhe në Suharekë është evidentuar një rritje e dukshme e intensitetit të reshjeve, të cilat tejkalojnë kapacitetet e sistemit të ujërave të zeza. Zona si Rrështani dhe Reçani raportojnë për vërshime të shpeshta dhe përzjerje të ujërave të zeza me ato atmosferike, duke krijuar probleme serioze sanitare.

Komuna e Suharekës nuk posedon një njësi të funksionalizuar për menaxhimin e emergjencave, gjë që e bën reagimin institucional të ngadaltë dhe të pakoordinuar. Ndërtimet urbane të realizuara pa respektimin e standardeve të urbanizmit dhe pa analiza të rrezikut e kanë rritur ndjeshëm ekspozimin ndaj fatkeqësive.

Shembulli tragjik nga komuna e Pejës në vitin 2023, ku humbën jetën një nënë dhe vajza e saj si pasojë e përmytjeve, dëshmon qartë për pasojat fatale të mungesës së planifikimit urban dhe tolerimit të ndërtimeve në zona të rrezikshme. Sipas vlerësimeve të ekspertëve të mbrojtjes civile, ndërtimi i shtëpisë në një zonë me rrezik për përmytje nuk është ndalur nga institucionet përkatëse, të cilat nuk kanë marrë masa për të parandaluar ndërtimin në atë vend. Rasti si ai i Pejës është një sinjal alarmi për domosdoshmërinë e vendosjes së standardeve rigoroze për ndërtimet në zonat me rrezik klimatik, si dhe për forcimin e inspektimeve dhe mbikëqyrjes së projekteve ndërtimore, për të shmangur pasojat e ngjashme në të ardhmen.

Në këtë kontekst, përballja me reshjet e dendura, vërshimet dhe pasojat e tyre kërkon një qasje të koordinuar ndër-institucionale, planifikim të bazuar në analiza të rrezikut, forcim të infrastrukturës, dhe edukim të komunitetit. Vetëm përmes harmonizimit të politikave mes nivelit qendror dhe atij lokal, mbështetjes financiare

adekuate dhe rritjes së kapaciteteve të përgjigjes, Kosova mund të përballet në mënyrë efektive me sfidat që vijnë nga ndryshimet klimatike.

Menaxhimi i mbeturinave dhe sfidat në nivel lokal në Kosovë

Kosova vazhdon të përballet me sfida thelbësore në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, sidomos në nivelin lokal. Edhe pse gjatë viteve të fundit janë shënuar përparime, si zgjerimi i mbulimit me shërbime të grumbullimit të mbeturinave në zonat rurale dhe vendosja e një rutine më të qëndrueshme për mbledhjen e tyre, ndarja e mbeturinave sipas standardeve të Bashkimit Evropian mbetet një ndër sfidat kryesore.

Standardet e BE-së kërkojnë ndarjen e mbeturinave që në burim përmes kontejnerëve të veçantë sipas kategorive – organike, plastike, metalike, qelq, letër dhe mbeturina të përgjithshme – të identifikueshëm përmes ngjyrave përkatëse (jeshile për qelq, verdhë për plastikë, kaltër për letër, etj.). Kjo ndarje është thelbësore për të mundur një riciklim efikas, për të zvogëluar sasinë e mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Megjithatë, përtej ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme, ndarja efektive e mbeturinave kërkon gjithashtu ndërgjegjësim të gjerë publik dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve. Në vendet e BE-së, kjo arrihet përmes fushatave të edukimit mjedisor dhe një sistemi funksional kontrolli dhe inspektimi. Në Kosovë, ndarja e mbeturinave është ende në fazat fillestare. Shumë komuna – si Prizreni, Suhareka, Fushë Kosova, Viti dhe Rahoveci – nuk kanë ende sisteme të zhvilluara për ndarjen e mbeturinave sipas kategorive, duke e bërë të pamundur përmbushjen e standardeve të BE-së për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave. Me sfidë të ngjashme përballen të gjitha komunat e Kosovës.

Sektori i riciklimit në Kosovë është po ashtu në një fazë të ngadaltë zhvillimi. Disa kompani private dhe iniciativa të shoqërisë civile janë aktive në grumbullimin dhe riciklimin e mbeturinave të caktuara, si plastika, letra apo mbeturinat ndërtimore, por mungesa e kapaciteteve teknike dhe infrastrukturore, investimeve të qëndrueshme dhe mekanizmave të fuqishëm ligjorë e kufizojnë përhapjen e këtyre përpjekjeve. Një shembull pozitiv është kompania "Golden Eagle" në Suharekë, e cila ka ndërtuar një fabrikë për riciklimin e mbeturinave ku janë të punësuar mbi 50 punëtorë. Fitimet nga aktiviteti riciklues përdoren për qëllime humanitare, ndërkohë që kompania ka shpërndarë mbi 50 kontejnerë për ndarjen e mbeturinave në nivel lokal.

Një tjetër sfidë madhore është hedhja e pakontrolluar e materialeve inerte – mbeturina nga ndërtimet dhe rrënimet – në ambiente të hapura apo në toka bujqësore. Ligji për Mbeturina dhe aktet nënligjore përkatëse parashohin që këto materiale të deponohen vetëm në vendepozita të licencuara, të menaxhuara nga operatorë të autorizuar. Komunat kanë përgjegjësi për përcaktimin dhe mbikëqyrjen e këtyre lokacioneve, por në praktikë, kjo zbatohet dobët për shkak të mungesës së monitorimit efikas. Si rezultat, shumë individë dhe kompani hedhin në mënyrë të paligjshme mbeturina inerte, duke dëmtuar seriozisht mjedisin dhe infrastrukturën publike.

Qytetarët dhe kompanitë që duan të deponojnë këto materiale në mënyrë të ligjshme shpesh përballen me barriera financiare dhe logjistike. Në shumicën e rasteve, ata duhet të paguajnë tarifa të konsiderueshme për transportin dhe deponimin, të cilat ndryshojnë sipas sasisë së mbeturinave dhe distancës deri te deponia më e afërt. Këto kosto janë të papërbalueshme për shumë qytetarë dhe përbëjnë një nga arsyet kryesore për përhapjen e deponive ilegale. Sipas të dhënave nga fokus-grupet lokale, qytetarët sugjerojnë që komunat të ofrojnë subvencione për transportin ose të organizojnë shërbime falas për grumbullimin e materialeve inerte. Një ndërhyrje e tillë do të ulte ndjeshëm hedhjen ilegale të mbeturinave ndërtimore dhe do të rrite respektimin e rregulloreve.

Për shkak të mungesës së kontrolleve rigoroze dhe masave ndëshkuese efektive, në shumë komuna janë krijuar deponi ilegale të mbeturinave inerte, të cilat ndotin tokën, ndotin burimet ujore dhe shpesh digjen në mënyrë të pakontrolluar, duke rrezikuar shëndetin publik përmes ndotjes së ajrit. Kjo gjendje kërkon ndërhyrje urgjente përmes një qasjeje të integruar, ku autoritetet lokale dhe ato qendrore të bashkëpunojnë ngushtë në forcimin e inspektorateve mjedisore, investimin në sisteme të monitorimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për pasojat afatgjata të ndotjes.

2. Vlerësimi i kapaciteteve lokale për përballje me ndryshimet klimatike në komunat e Kosovës

Bazuar në të dhënat dhe analizat nga fokus grupet në komunat e Vitisë, Prizrenit, Fushë Kosovës, Suharekës dhe Rahovecit, rezulton një gjendje e brishtë dhe e fragmentuar e kapaciteteve institucionale për përballjen me sfidat që sjellin ndryshimet klimatike. Pothuajse të gjitha komunat e përfshira në studim përballen me sfida të theksuara në aspektin njerëzor, teknik, financiar dhe rregullativ, që ndikojnë në një reagim të fragmentuar, të ngadaltë, dhe joefikas ndaj krizave klimatike.

Mungesa e ekspertizës profesionale dhe e trajnimeve të specializuara për zyrtarët komunalë është një nga pengesat kryesore. Shpesh, komunat nuk disponojnë struktura të dedikuara për menaxhimin e emergjencave. Planet ekzistuese për reagimin ndaj fatkeqësive natyrore janë ose të papërditësuara, ose nuk zbatohen, apo madje nuk ekzistojnë fare, duke lënë institucionet pa një kornizë të qartë veprimi në rast krizash.

Shembulli i Komunës së Suharekës është ilustrues: ndërsa nevoja është për 40 zjarrfikës, komuna ka vetëm 15, me pajisje të pamjaftueshme. Mungesa e një objekti funksional për vendosjen e automjeteve të zjarrfikësve, të cilat qëndrojnë jashtë edhe gjatë dimrit, rrezikon vonesa serioze në reagim. Një situatë e ngjashme paraqitet edhe në Rahovec, ku mungesa e një strategjie klimatike afatgjatë, koordinimi i dobët me nivelin qendror dhe burimet e pamjaftueshme financiare e kufizojnë aftësinë për t'u përballur me fenomene si ngricat, breshëri dhe thatësi.

Kapacitetet financiare mbeten një nga sfidat më të mëdha. Komunat nuk kanë buxhete të dedikuara për emergjencat të ndërlidhura me ndryshimet klimatike dhe shpesh nuk arrijnë të realizojnë as ndërhyrjet bazike, si pastrimi i lumenjve apo blerja e pajisjeve emergjente. Mungesa e bashkëpunimit të strukturuar me nivelin qendror dhe burokracia pengojnë qasjen në fonde dhe efikasitetin institucional. Ligjet për mbrojtjen e ambientit zbatohen në mënyrë të pamjaftueshme; mungesa e inspektimeve, gjobave efektive dhe vullnetit politik ka krijuar një kulturë pandëshkueshmërie, që nxit shkelje si ndotja e lumenjve, djegia e pyjeve dhe ndërtimet pa leje. Ndërgjegjësimi mbi ndikimet klimatike ekziston në sektorët kyç si shëndetësia, bujqësia, arsimi dhe emergjencat, por kapacitetet për reagim mbeten të kufizuara. Plani i fundit për vlerësimin e rreziqeve daton nga viti 2016 në komunën e Vitisë, dhe nuk është përditësuar. Mungesa e të dhënave të përditësuara dhe e ekspertizës për hartimin e planeve gjithëpërfshirëse paraqet një boshllëk të theksuar. Gjithashtu, mungesa e koordinimit me nivelin qendror, veçanërisht për menaxhimin e lumenjve dhe ndotjen nga ujërat e zeza, e vështirëson përballjen me përmytjet e përsëritura, veçanërisht ato që shkaktohen nga përrockat ndërkomunale.

Po ashtu, në Viti ekziston mungesë e stafit të trajnuar dhe pajisjeve adekuate për ndërmarrjen e veprimeve të qëndrueshme, si pastrimi i lumenjve apo ndërtimi i infrastrukturës për riciklim. Ndërgjegjësimi qytetar mbetet i ulët dhe masat ndëshkuese për shkelje mjedisore janë rezultuar joefektive – përfshirë rastet kur janë dhënë gjoba për djegien e pyjeve, mungesa e ndëshkimeve konkrete ka çuar në përsëritje të shkeljeve.

Dallime të dukshme paraqiten ndër komunat e përfshira në studim. Prizreni dhe Rahoveci kanë avancuar më shumë, duke hartuar plane emergjencash dhe reagimi ndaj fatkeqësive natyrore në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit dhe të miratuara nga Agjencia për Menaxhim Emergjent. Këto plane përcaktojnë qartë hapat që duhet ndërmarrë në situata krizash, duke krijuar një bazë institucionale më të fortë për ndërhyrje të shpejta dhe të koordinuara.

Në përfundim, shumica e komunave në Kosovë përballen me sfida serioze në reagimin ndaj ndryshimeve klimatike: mungesë burimesh njerëzore dhe teknike, buxhete të kufizuara, zbatim të dobët ligjor dhe mungesë koordinimi institucional. Për një reagim më të qëndrueshëm dhe efektiv, janë të nevojshme masa strategjike, përfshirë krijimin e strukturave të dedikuara për emergjencë klimatike, rritjen e trajnimeve për stafin, përmirësimin e inspektimit dhe integrimin e planeve lokale me politikat kombëtare. Përfshirja aktive e komuniteteve dhe shkollave në edukimin klimatik, si dhe mobilizimi i fondeve për investime në infrastrukturë mbrojtëse, janë gjithashtu elementë kyç për forcimin e reziliencës klimatike në nivel lokal.

Një tjetër sfidë thelbësore është procesi i lëshimit dhe monitorimit të lejeve të ndërtimit. Të dhënat nga fokus-grupet tregojnë se shumica e komunave hasin vështirësi serioze në këtë drejtim. Në shumë raste, gjatë dhënies së lejeve nuk merren parasysh standardet inxhinierike dhe infrastrukturore të nevojshme për përballimin e rreziqeve klimatike dhe degradimit mjedisor. Madje, në Rahovec dhe Fushë Kosovë vihet në pah lëshime gjatë procesit të dhënies së lejeve të ndërtimit duke shkelur kriteret e bazike të ndërtimit, duke lejuar ndërtimin e shtëpive në zonat bujqësore dhe në vreshta. Ky përceptim/obesrvim nga qytetarët pjesmarrës dhe toni me të cilin pjesmarrësit ju qasën kësaj teme, lë të kuptohet që ky problem nuk është i ri e as i kufizuar por i shtresuar dhe sistematik.

Shpesh, lejet e ndërtimit jepen për ndërtim në zona të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, si përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut. Kjo sjell jo vetëm rrezik për jetën dhe pronën, por tregon dobësi institucionale në menaxhimin territorial dhe mbrojtjen e mjedisit. Siç u shpreh njëri nga pjesmarrësit në Rahovec: *"Komuna i mbyllë sytë kur pronarët e parcelave bujqësore ndërtojnë vila në toka të dedikuara për vreshta kryesisht dhe ku ndalohet rreptësisht ndërtimi; Në rastin më të mirë vjen inspektori dhe vendos shiritat, të nesërmen ato hiqen dhe puna vazhdon pa problem"*. Në pyetjen se a keni njoftuar ndonjëherë ju vet komunën për këto raste të evidentuara disa pjesmarrës u shprehën se po, madje edhe policinë. Disa shpjeguan se lajmërimi nuk prodhon asgjë, pasi që komuna toleron, e pastaj kjo po kthehet në problem personal mes ndërtuesit (pronarit të tokës) dhe atij/asaj që e ka lajmëruar rastin.

Gjithashtu, shumë kompani që marrin leje ndërtimi nuk respektojnë kriteret bazë të ndërtimit të qëndrueshëm dhe standardet mjedisore, duke rritur rrezikun nga fatkeqësitë natyrore. Ndërtimet e pakontrolluara, mungesa e sistemeve të ujërave të zeza, sistemi joefikas i menaxhimit të ujërave atmosferikë dhe degradimi i mbrojtjes natyrore të lumenjve dhe tokave kanë bërë që zona të mëdha urbane të jenë më të ekspozuara ndaj përmbytjeve të shpeshta. Kjo ishte evidentuar në fokus grupin me pjesmarrës nga Prizreni, mirëpo sic edhe është raportuar edhe në raportin paraprak të PREVENT, me këso problemesh ballafaqohen të gjitha komunat e mëdha, sidomos Prishtina.

Kapacitetet lokale për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të lejeve janë shumë të kufizuara. Mungesa e stafit teknik, inspektorëve dhe mjeteve bën të vështirë ndjekjen e proceseve të ndërtimit dhe garantimin e përputhshmërisë me rregulloret ligjore dhe klimaterike. Kjo krijon një hendek të madh ndërmjet planeve të miratuara dhe realitetit në terren, duke vënë në rrezik sigurinë urbane dhe mbrojtjen afatgjatë të territorit.

Në mungesë të një qasjeje të integruar ndërmjet planifikimit urban, menaxhimit të rrezikut dhe mbrojtjes së mjedisit, procesi i lejeve të ndërtimit vazhdon të jetë i papërgatitur për sfidat e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve të qëndrueshme urbane

3. Perceptime Lokale për Ndryshimet Klimatike

Kjo pjesë përmbledh gjetjet nga fokus grupet e mbajtura në komunat: Viti, Suharekë, Rahovec, Prizren. Çdo seancë përfshiu pjesëmarrës të larmishëm përfshirë zyrtarë komunalë, përfaqësues të shoqërisë civile, të rinj, fermerë dhe aktivistë, duke ofruar një kuptim shumëdimensionale të perceptimeve dhe kapaciteteve lokale përballë ndryshimeve klimatike. Edhe pse diskutimet ndoqën një strukturë gjysmë të hapur të bazuar në katër shtylla kryesore, pjesëmarrësit shpesh ndërlidhnin përvojat personale me pritshmëritë institucionale dhe përgjegjësitë qytetare.

Vetëdija, njohuritë dhe përgatitja e qytetarëve

Të dhënat nga fokus grupet e organizuara në pesë komuna tregojnë si njohuri të përbashkëta ashtu edhe dallime të rëndësishme në vetëdijen lokale, reagimin institucional dhe përfshirjen e komunitetit në lidhje me ndryshimet klimatike. Pjesëmarrësit shpesh kalonin lirshëm midis shtyllave, duke nxjerrë në pah natyrën e ndërlidhur të perceptimeve klimatike dhe përvojave politike. Përgjithësisht është vërejtur një disponim i mirë i të gjithë pjesëmarrësve për t'u përfshirë në temat që ndërlidhen me pasojat e ndryshimeve klimatike.

Pavarësisht ndikimeve të dukshme të ndryshimeve klimatike, pjesëmarrësit në të gjitha komunat treguan nivele të ndryshme të vetëdijes dhe kuptimit. Në Viti, një përfaqësues nga sektori i emergjencës hapi diskutimin me një deklaratë reflektuese por pragmatike:

"Pavarësisht diskutimit a ka a s'ka ndryshime klimatike, në bazë të pasojave ne veç duhet me kqyr çka me bo?", duke argumentuar se Kosova dhe niveli lokal, nuk mundën aspak të ndryshojnë qasjen globale ndaj klimës, por tërë energjinë duhet ta fokusojnë në adresimin e pasojave që sjellin ndryshimet klimatike në çështjet e sigurisë.

Ndikimet e perceptuara klimatike

Në Rahovec, pjesëmarrësit, kryesisht fermerë dhe përfaqësues të sektorit bujqësor, ngritën shqetësimin e madh që lidhet me ngricat pranverore të papritura dhe stuhitë intensive të breshërit, të cilat kanë lënë pasojat të drejtpërdrejta në jetesën e tyre si shkaktar të ndryshimeve klimatike. Fermerët raportuan dëme të mëdha në pemëtari dhe sidomos në vreshta – një sektor kyç për ekonominë lokale të kësaj komune. "Këtë vit humbëm kumbulla, qershi, mollë për shkak të ngricave – ndryshimet klimatike po shkatërrojnë gjithçka," tha një pjesëmarrës me ton të lodhur dhe të

frustruar. Për ta, klima nuk është një çështje teorike apo statistikore, por një realitet që përkthehet në humbje të të ardhurave dhe pasiguri ekonomike.

Në Prizren, diskutimi u dominua nga një grup i të rinjve që përshkruan përjetimet e tyre me valët e të nxehtit gjithnjë e më të shpeshta, të cilat ndikojnë jo vetëm në mirëqenien personale por edhe në aktivitetet shoqërore dhe jetesën në qytet. Ata përmendën gjithashtu dimrat më të butë, të cilët perceptohen si "të çuditshëm" në krahasim me përvojat e mëparshme. Megjithatë, në diskutim u vu re një ngatërrim i dukshëm mes ndryshimeve klimatike dhe problemeve të tjera mjedisore apo sociale, si ndotja urbane ose mungesa e infrastrukturës së gjelbër. Një pjesëmarrës pranoi: *"E dimë që diçka nuk po shkon me motin, por s'e dimë a është klimë, a ndotje, a thjesht rastësi."* Kjo dëshmon për nevojën e edukimit klimatik më të thelluar dhe më të strukturuar për të rinjtë.

Në Suharekë dhe Prizren një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish përmendën me shqetësim të madh ritjen e rasteve të zjarreve në zona pyjore dhe bujqësore, të cilat shpeshherë nuk janë të rastësishme, por të qëllimshme dhe të lidhura me praktika të dëmshme të cilat shkaktohen nga qytetar të pa-përgjegjshëm. Në të dy komunat u përmend gjithashtu cilësia e dobët e ajrit, veçanërisht gjatë muajve të dimrit kur përdoren burime joefikase për ngrohje si qymyri dhe druri. Pjesëmarrësit gjithashtu ngritën alarmin për zgjerimin urban të pakontrolluar, sidomos në Fushë Kosovë, ku ndërtimet e reja shpesh tejkalojnë kapacitetet infrastrukturore ekzistuese, duke krijuar probleme të mëdha me kullimin, përmbytjet dhe ndotjen. "Qyteti po paguan çmimin për mungesën e planifikimit para 10 vitesh," tha një banor lokal.

Në Viti, diskutimi u thellua më shumë në çështje të ndërlidhura me mirëmbajtjen e lumenjve dhe kanaleve ujitëse, të cilat, sipas pjesëmarrësve, janë shpesh të bllokuara, të keqmenaxhuara ose jashtë kompetencave të qarta institucionale. U përmend gjithashtu mungesa e bashkëpunimit të strukturuar midis komunës dhe nivelit qendror, sidomos për çështje që tejkalojnë kapacitetet lokale si (ri)pyllëzimi, mbrojtja nga erozioni dhe kontrolli i ndotjes nga aktivitetet bujqësore. Një zyrtar lokal deklaroi: *"Ne si komunë s'e kemi kapacitetin teknik për të trajtuar rrjedhën e ujërave – kjo kërkon koordinim me ministrinë, por përgjigjet vonojnë ose mungojnë."* Kjo dëshmon për një mungesë të theksuar të qartësisë institucionale dhe kapaciteteve operacionale në nivel lokal për menaxhimin e pasojave klimatike.

Nga diskutimet në fokus-grupet lokale doli që komunat, së bashku me donatorë, OJQ dhe media, kanë bërë shumë fushata informuese për qytetarët mbi ndryshimet klimatike, pasojat e tyre dhe mënyrat si duhet të veprojmë për t'i përballuar. Pra,

njerëzit kanë marrë informacionet bazë dhe e dinë pse është e rëndësishme të merren masa.

Por problemi është se, megjithatë, mungon vetëdija e vërtetë dhe edukimi i thelluar që do t'i bënte njerëzit të ndryshojnë realisht sjelljen e tyre. Shumë nga pjesëmarrësit thanë se ende nuk ka një kulturë të fortë qytetare që na bën të kujdesemi për tokën dhe ambientin, të mos ndezim zjarre në pyje apo fusha, të mos hedhim mbeturina rrugëve, të mos digjen mbeturina dhe të kursejmë ujin. Edhe pse ka shumë fushata, komuniteti në Kosovë vazhdon të jetë shkaktar i ndotjes së lumenjve, zjarreve që digjen qëllimisht dhe mbeturinave të hedhura jashtë vendit.

Pra, nuk mjafton të japim thjesht informacione; duhet të ndërtojmë një edukim dhe një kulturë të përgjegjshme që njerëzit ta kuptojnë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Për këtë duhet të punohet shumë edhe në shkolla, edhe në komunitete, me programe që i mësojnë njerëzit të jenë më aktivë dhe më të kujdesshëm për ndryshimet klimatike.

Gjithashtu, mediat lokale dhe organizatat qytetare mund të luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen e këtyre ndryshimeve, duke punuar ngushtë me komunat dhe duke ndihmuar në zbatuarjen e masave që ndalojnë shkeljet mjedisore.

Boshllëqet në informim dhe sjellje

Edhe pse shumë qytetarë pranojnë se mjedisi po përkeqësohet, pak prej tyre mundën të shpjegojnë shkaqet apo të lidhnin sjelljet e tyre me pasojat. Në Prizren, qytetarët pohuan se “nuk janë të informuar” dhe as që kanë kërkuar ndonjëherë informacion të besueshëm. Një pjesëmarrës theksoi: “Nuk më ka ndodhë ndonjëherë që dikush të më ketë shpjegu qartë çka është ndryshimi klimatik.” Kjo mungesë e nxitjes së kërkimit të dijes shihet si pasojë e një ambienti informues pasiv dhe mungesës së edukimit formal mbi klimën. Tutje në këtë diskutim u vërejt që të rinjtë ndonëse kanë llogari të ndryshme sociale si Instagram, TikTok apo FB, për shkak të mos-interesimit për t'u informuar me pasojat e ndryshimit të klimës, duket që algoritmet favorizuese të rrjeteve sociale për rrjedhim nuk nxjerrin asgjë nga kjo temë. Kjo u tha edhe nga njëri prej pjesëmarrësve

“Ne nuk interesohemi asnjëherë për çështjet që lidhen me komunën apo ato institucionale në përgjithësi. Nuk dijmë se cka supozohet me bo komuna. Por edhe nuk është që interesohemi për pasojat apo se çka na duhet me bo si t'ri veq e di që po i pyte t'rinjtë krejt kanë me thanë që ishim kon të gatshëm me kontribu qyshdo që osht e mundshme”

Deklarata të tilla të observuara, nxjerrin në pah një dukuri përsëritëse: Të rinjtë ndonëse përceptojnë ndryshimet klimatike si diçka të vërtetë, nuk e ndërlidhin me përvojën personale si pasojë e mos-interesimit apo edhe si pasojë e mos-angazhimit direkt në diskutime, punëtori, aktivitete apo edhe ngjarje që zhvillohen nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit jo-formal.

Në Suharekë situata duket të jetë më pozitive në raport me vetëdijen kolektive për pasojat e ndryshimit të klimës. Përcemptimi sikurse në komunat tjera ndërlidhet me faktin që ka numër të zjarreve më të madh, ka vërshime më të shpeshta e të paprecedenta, ka reshje më të vrullshme et. Ndër tjera u përmend fakti që disa kultura bujqësore nuk kultivohen më për shkak të ndryshimeve klimatike.

Theksi, sikurse në komunat tjera u vendos tek faktori njeri i cili po e vështirëson përballjen me pasojat e ndryshimeve klimatike, sidomos fenomeni i ndezjes së zjarreve. Një pjesëmarrës tha: *"Të gjithë e dinë që nuk duhet të ndezin zjarre, por prapë e bëjnë."* Kjo deklaratë nxjerr në pah hendekun ndërmjet vetëdijes sipërfaqësore dhe sjelljes konkrete, që shpesh është e lidhur me mungesën e ndëshkimit institucional ose tolerancën shoqërore ndaj shkeljeve mjedisore. Në të njëjtën linjë, në Rahovec, pjesëmarrësit treguan që edhe pse kanë parë fushata kundër ndotjes apo djegies, efekti i tyre praktik është minimal për shkak të mungesës së zbatimit dhe mbikëqyrjes.

Në Fushë Kosovë, pjesëmarrësit theksuan se përveç përmytjeve dhe kushteve të përkeqësuar të jetesës, ata ndjehen të pambështetur dhe të dezinformuar. Një nga pjesëmarrëset deklaroi: *"Nuk ka një vend ku mund të shkosh dhe të pyesësh qartë se çfarë duhet bërë për ndonjë problem që ndërlidhet me vërshimet."*

Në Rahovec, pjesëmarrësit gjithashtu përmendën se asnjë nga iniciativat mjedisore në shkolla nuk ka trajtuar seriozisht temën e ndryshimeve klimatike. Shumë prej të rinjve mendojnë se klima është thjesht një çështje e largët, e përqendruar në botën perëndimore dhe jo diçka që ndikon jetën e tyre të përditshme. Po ashtu, në këtë grup të larmishëm, pjesëmarrësit potencuan faktin që për klimën, pasojat, përgjegjësitë dhe veprimet që duhen ndërmarrë, flitet vetëm në ditët e shënuara si Dita e Tokës. Shpesh këto aktivitete janë të nxituara nga organizata të shoqërisë civile, grupe tjera jo-formale dhe më pak nga shkollat fillore. Sidoqoftë, një tendencë e tillë jo sistematike dhe pa ndonjë angazhim gjithëpërfshirës vështirë se mund të prodhojë çfarëdo efekti të dëshiruar.

Disa pjesëmarrës diskutuan mbi rëndësinë që kanë aksionet e pastrimit të ambientit si veprime konkrete nga ku komunitetet e ndryshme mund të ndërgjegjësohen. *"Kamë ardhë nga Gjermania për të investuar në Rahovec. Gjëja e parë që ë pengon janë*

mbeturinat. Këtu shihet që nuk ka vetëdije për rëndësinë e mjedisit. Unë vet kam ndërmarrë veprime të pastrimit dhe kam ftuar shokët në FB të më bashkëngjiten". Ndonëse kjo deklaratë dhe tjera të ngjajshme që ndërlidhin ruajtjen e ambientit me pasojat klimatike është vështuar si e mangët dhe e pa koherencë thelbësore në raport me pasojat e ndryshimeve klimatike, në prizmin e vullnetit për veprim vërehet që pjesmarrësit i shohin aksionet e pastrimit dhe ruajtjes së ambientit si metoda të mira komunitare për të marrë vëmendje dhe vetëdijësuar qytetarët. Siç u shpreh njëra nga pjesmarrëset gjatë kësaj pike të diskutimit "Secili jemi të gatshëm për të bërë dicka si pastrimi i lagjeve e i lumenjëve, me kushtin që mundemi me i vetëdijësu qytetarët që ne jemi përgjegjës për vështirësimin/trashjen e pasojave si vërshimet dhe zjarret". Pjesëza të ngjajshme diskutimi u zhvilluan në të gjitha komunat pjesmarrëse, të cilat nxjerrin në pah gatishmëri për t'u përfshirë në veprime kolektive që potencialisht do ngrisin vetëdijen qytetare, mirëpo, përtej vullnetit dhe gatishmërisë, pjesmarrësit nuk demonstrojnë njohuri dhe aftësi për të kanalizuar vullnetin e tyre të mirë.

Për të kuptuar këtë edhe më tepër, pjesmarrësve ju parashtruan pyetje në lidhje me ndërveprimin e tyre (sa i përket çështjeve të ndërlidhura me klimën) me nivelin komunal si Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale. U theksua se mungesa e përfshirjes qytetare në proceset vendimmarrëse ka krijuar një boshllëk të madh midis autoriteteve dhe komunitetit. Në disa komuna, si në Fushë Kosovë, Rahovec dhe Prizren, qytetarët pohuan se nuk kishin asnjëherë mundësi të angazhoheshin në diskutime publike mbi prioritetet klimatike ose planet zhvillimore. Kjo mungesë transparence dhe qasje në informacion është kthyer në një faktor shtesë që pengon formimin e një kulture përgjegjësie kolektive dhe vetëiniciative.

Një element tjetër që doli shpesh gjatë diskutimeve ishte mungesa e besimit në burimet zyrtare të informacionit. Në mungesë të platformave të qarta komunikimi institucional, shumë qytetarë mbështeten në burime jozyrtare ose në rrjete sociale, të cilat shpesh përçojnë informacione të pasakta ose të pjesshme. Kjo situatë thellon konfuzionin dhe çon në ndarje mes realitetit të përditshëm dhe asaj çfarë perceptohet si e drejtë ose e nevojshme për t'u bërë në lidhje me ndryshimet klimatike. Në ndërlidhje me këtë pikë, pas zhvillimit të diskutimit pjesëmarrësit duket se kishin ide se cka mund të bëhet në këtë drejtim. Në të gjitha komunat përmendën mungesën e figurave publike që do të mund të përçonin mesazhe të qarta dhe të kuptueshme për qytetarët. Ata shprehën nevojën për "zëra të besueshëm", si mësues, aktivist të komunitetit, mjekë apo figura të njohura në komunitet, të cilët mund të luajnë rol kyç në përhapjen e njohurive mbi rreziqet klimatike dhe masat parandaluese. Këto tipare dalluese të diskutimeve ku qytetarët shprehen lirshëm mbi atë se çka do duhej t'ishte më mirë, tregojnë për rëndësinë që pjesmarrësit i

japin temave sociale dhe klimës si personat me ndikim në komunitete të ndryshme. Pa përfshirjen e këtyre ndërmjetësve shoqërorë, informacioni teknik shpesh mbetet abstrakt dhe nuk arrin të shndërrohet në sjellje konkrete.

Së bashku me ndjesinë e përjashtimit nga institucionet publike, shumë të rinj në fokus grupet në Prizren dhe Suharekë përmendën edhe mospërfshirjen e tyre në aktivitetet e organizuara nga OJQ-të, shoqatat mjedisore dhe grupet e tjera joformale që veprojnë në komunitet. Përkundër numrit të konsiderueshëm të organizatave të shoqërisë civile që operojnë në këto komuna, të rinjtë raportuan se bashkëpunimi me ta është i rastësishëm, jostrategjik dhe shpesh i bazuar në kontakte personale, jo në struktura të qëndrueshme për angazhim. *"Ka OJQ që bëjnë projekte për klimën, po askush nuk na ka ftu neve,"* tha një pjesëmarrëse nga Suhareka.

Kjo ndarje sugjeron një mospërputhje midis potencialit të të rinjve dhe mënyrës si operojnë strukturat ekzistuese të shoqërisë civile. Në vend që të shfrytëzojnë kreativitetin, energjinë dhe shqetësimet e drejtpërdrejta të të rinjve, shumë OJQ dhe iniciativa lokale mjedisore duket se funksionojnë në mënyrë të mbyllur, pa hapur dyer për pjesëmarrje të reja ose pa ndërtuar ura drejt komuniteteve rinore në shkolla, lagje apo në hapësira publike.

Një tjetër dimension i rëndësishëm është mungesa e grupeve të formalizuara komunitare të të rinjve që do të mund të vepronin si kanale ndërmjetëse ndërmjet qytetarëve të rinj dhe institucioneve lokale. Ndërsa në disa komuna ekzistojnë këshilla lokale ose qendra rinore, të rinjtë i përshkruan këto si joaktive, të politizuara ose jo-funksionale. Po ashtu, grupet jo-formale ad-hoc, që shpesh krijohen rreth ndonjë problemi lokal (si zjarret, ndotja e një lumi, ose mbeturinat në një lagje), nuk gëzojnë mbështetje nga komuna apo ndonjë rrjet institucional që do t'i fuqizonte në mënyrë të qëndrueshme.

Në thelb, përjashtimi i të rinjve nuk është vetëm një mungesë mundësie, por një dështim sistematik në bashkërendimin ndërmjet OJQ-ve, komunave dhe vetë komunitetit. Kjo situatë kërkon qasje më të koordinuar, ndërsektoriale dhe afatgjatë, që të ndërtojë ura të besueshme për përfshirjen e qëndrueshme të të rinjve në çështje klimatike – jo vetëm si përfitues të fushatave, por si aktorë që ndikojnë, formulojnë dhe zbatojnë zgjidhje lokale.

Përfundimi

Nga diskutimet me pjesëmarrësit në fokus grupe, ajo që doli në pah ishte hendeuku i thellë mes vetëdijes teorike dhe sjelljes praktike: qytetarët pranojnë ekzistencën e ndryshimeve klimatike, por nuk kanë njohuritë dhe mjetet për të vepruar. Mungesa e komunikimit institucional, përjashtimi i të rinjve nga proceset formale, roli i kufizuar i shkollave dhe shkëputja midis OJQ-ve dhe komunitetit kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të fragmentuar, ku mungesa e besimit dhe e strukturës pengojnë çdo nismë të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, janë identifikuar pesë propozime kryesore që pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e shprehura nga pjesëmarrësit dhe që mund të shërbejnë si bazë konkrete për ndërhyrje të orientuara në nivel lokal. Të ndërtuara mbi deklaratat, përkrahjet dhe analizat e qytetarëve, këto propozime synojnë të ndërtojnë ura të reja ndërmjet institucioneve, shoqërisë civile dhe komunitetit:

Tabela më poshtë përmbledh secilin prej këtyre propozimeve, reflektimet përkatëse nga pjesëmarrësit dhe elaborimin e shkurtër për secilin:

Rekomandimi	Reflektimi nga pjesëmarrësit	Shtjellimi i propozimit
Krijimi i një platforme lokale për informim dhe edukim mbi klimën	Qytetarët nuk janë të informuar dhe nuk kanë ku të drejtohen për pyetje mbi klimën.	Platforma të ofrojë informacione të thjeshtuara dhe të aksesueshme për publikun mbi ndryshimet klimatike, pasojat lokale, dhe rolin e qytetarëve, përmes këndeve komunale dhe faqeve digjitale në gjuhën shqipe.
Fuqizimi i aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuere në shkolla	Në shkolla flitet për klimën vetëm në Ditën e Tokës, në mënyrë sipërfaqësore.	Programet shkollore të pasurohen me aktivitete praktike dhe interaktive që lidhen me klimën, duke përfshirë klube ekologjike, projekte komunitare dhe edukim përmes përvojës.
Ndërtimi i rrjeteve bashkëpunuese midis komunave, OJQ-ve dhe grupeve rinore	Të rinjtë ndihen të përjashtuar nga aktivitetet e OJQ-ve dhe nuk ka struktura të qëndrueshme për angazhim.	Të krijohen forume rinore të strukturuar dhe mekanizma formalë për partneritet ndërmjet komunave, OJQ-ve dhe grupeve joformale me qëllim bashkë-dizajnimin e zgjidhjeve klimatike.

Fushata të qarta të ndërgjegjësimit me ndërmjetës të besueshëm lokalë	Mungojnë figura publike që përçojnë mesazhe të qarta klimatike; ka mungesë të besimit në burime zyrtare.	Të zhvillohen fushata në bashkëpunim me figura me ndikim në komunitet për të rritur vetëdijen përmes mesazheve të qarta, të përshtatura dhe të përhapura përmes kanaleve të besueshme lokale.
Ngritja e kapaciteteve për veprim kolektiv komunitar dhe ndëshkueshmëri efektive	Disa shkelje si ndezja e zjarreve ndodhin pavarësisht vetëdijes, për shkak të mungesës së ndëshkimeve dhe mbikëqyrjes.	Komunitetet të trajnohen për të organizuar aksione kolektive si pastrimi dhe raportimi i ndotjes, të shoqëruara me inspektime dhe mekanizma funksionalë ndëshkimi për shkeljet mjedisore.

REKOMANDIMET si ndërlidhje strategjike sektoriale

1. “Nuk dimë ku me pyet dhe nuk ka kush me na tregu”

Krijimi i platformave komunale për informim dhe ndërgjegjësim klimatik

Propozimi: Komunat të krijojnë pika informacioni (online dhe fizike) ku qytetarët të marrin informacione të qarta dhe praktike mbi ndryshimet klimatike dhe masat e reagimit. Këto pika duhet të jenë pjesë e zyrave të shërbimeve publike dhe faqes zyrtare të komunës. Mund të përdoren grantet e UNDP/OSBE për pilotimin e tyre.

Lidhja strategjike: ⁴

UNDP (2024) thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit publik (SDG 13.3);

Raporti i BE-së për Kosovën (2024) sugjeron forcim të kapaciteteve të komunikimit mjedisor.

Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019–2028 thekson domosdoshmërinë e ndërgjegjësimit të publikut në nivel lokal për adaptim dhe mbrojtje ndaj klimës, gjë që i jep mbështetje të fortë propozimit për platforma informuese klimatik për qytetarët, me qasje të drejtpërdrejtë dhe transparente.

Strategjia e Sigurisë 2022–2027 identifikon kërcënimin e ndryshimeve klimatike si pjesë të “Siguria Mjedisore” dhe nxit komunikimin ndër-institucional dhe bashkëpunimin me komunitetet në segmentin e emergjencave klimatike – një trajektore që mbështet ndërtimin e pikave komunale për informim klimatik si mekanizëm shpërndarjeje informacioni.

2. “Flasim për klimën vetëm më 22 Prill”

Integrimi i edukimit klimatik në arsimin formal dhe joformal

Propozimi: Cështjet e ndërlidhura me pasojat klimatike të përfshihen si lëndë/njësi mësimore të shkollave (klasat 5–12), duke përfshirë eksperimente, klube, stacione moti në shkolla dhe panaire klimatike vjetore.

Opsion - Edukatorët të trajnohen nga UNDP/UNICEF etc.

⁴ **UNDP Kosova.** *Raporti i Arritjeve, 2024.* Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – Zyra në Kosovë.

Ky raport thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit publik dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për edukim klimatik, si pjesë e përmbushjes së Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm SDG 13.3.

Komisioni Evropian. (2024). *Raporti për Kosovën 2024.*

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (2019). *Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019–2028.*

Zyra e Kryeministrit. (2022). *Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022–2027.*

Lidhja strategjike:⁵

UNDP raporto i fushata të suksesshme për rritjen e vetëdijes së të rinjve në mjedis; BE mbështet integrimin në kurrikulat lokale përmes Axhendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Strategjia për Arsim Parauniversitar 2022–2026 thekson në mënyrë të qartë rëndësinë e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe integrimin e temave të mjedisit në kurrikulën shkollore. Në veçanti, shtylla strategjike 2.4 kërkon “zhvillimin e përmbajtjeve që nxisin ndërgjegjësimin ekologjik dhe klimatik tek të rinjtë” dhe krijimin e mundësive për mësim të bazuar në projekte praktike në komunitet.

Strategjia e Mjedisit për Kosovën identifikon edukimin mjedisor si një prej faktorëve kyç për ndryshim të sjelljes qytetare dhe menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore. Nën kapitullin 6, theksohet nevoja për “ndërtimin e kapaciteteve në sistemin arsimor për të përfshirë edukimin klimatik dhe për të ndërtuar kulturën e qëndrueshmërisë”.

3. “Komuna i mbyllë sytë”

Përfshirja e analizës së rrezikut klimatik në lejet e ndërtimit

Propozimi: Në procesin e lejeve ndërtimore duhet të shtohet analizë zgjeruar e rrezikut (përmbajtje, zjarre), e parë nga specialistë të trajnuar.

Lidhja strategjike:⁶

Strategjia e Sigurisë 2022–2027 e specifikon qartë nevojën për planifikim urban të orientuar nga rreziku dhe përgatitje emergjente në nivel lokal, duke përfshirë ndërlidhjen mes institucioneve dhe komunitetit.

⁵ **UNDP Kosovo.** (2024). *Kosovo Earth Days: Fushata për ndërgjegjësimin ambientale të të rinjve dhe komunitetit.*

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. (2023). *Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor: Raporti i Zbatimit të Planit të Veprimit 2022–2023.*

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). *Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2022–2026.*

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022). *Strategjia për Mjedis 2022–2031.*

⁶ **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.** (2022). *Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2022–2026*

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022). *Strategjia për Mjedis 2022–2031.*

World Bank Group. (2024). *Kosovo Country Climate and Development Report.* Washington, DC

Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit. (2022). *Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022–2027.*

World Bank CCDR 2024 thekson rëndësinë e risk-informed planning, duke sugjeruar ndërtimin e kapaciteteve shtetërore për vlerësimin e rreziqeve dhe angazhimin e financimeve private/internacional si pjesë e zbatimit të strategjive klimatike.

Strategjia e Mjedisit 2022–2031 dhe Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2022–2026 mbështesin ide si përdorimi i analizave të rrezikut në nivel lokal dhe edukimi për klimën në shkolla si pjesë e tranzicionit drejt zhvillimit të gjelbër dhe rezilient.

4. “Planet janë në zyrë, por askush nuk i sheh”

Hartimi dhe funksionalizimi i planeve lokale emergjente

Propozimi: Komunitet të përtërijnë planin lokal të reagimit ndaj fatkeqësive, duke implementuar ushtrime stërvitore vjetore, meta alarmi dhe përditësime bazuar në skenarë lokalë.

Lidhja strategjike:⁷

Sendai Framework kërkon plane të bazuara në rrezik në nivel lokal kërkon që niveli lokal të luajë rol qendror në hartimin dhe zbatimin e planeve për zvogëlimin e rrezikut, duke promovuar qeverisje lokale të orientuar nga rreziku dhe ndërtimin e reziliencës në komunitet.

World Bank Ready-2-Respond (2021) rekomandon sistematizim emergjent në nivel lokal.

Banka Botërore sugjeron sistematizimin e kapaciteteve të reagimit emergjent në nivel lokal, përmes një metodologjie që vlerëson infrastrukturën, burimet njerëzore, legjislacionin dhe kapacitetet institucionale për një reagim më efektiv dhe të koordinuar.

Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028 thekson rëndësinë e përfshirjes së komunave në zbatimin e planeve të reduktimit të rrezikut, përfshirë planifikimin emergjent, koordinimin ndër-institucional dhe pjesëmarrjen e komunitetit lokal.

Strategjia për Mjedis 2022–2031 përmend përdorimin e qasjeve të orientuara nga rreziku për menaxhimin e mjedisit, planifikimin urban dhe ruajtjen e resurseve

⁷ **Sendai Framework** - për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015–2030.

Banka Botërore & GFDRR. (2021). *Kosova – Vlerësimi Diagnostik i Gatishmërisë për Reagim ndaj Emergjencave (Ready-2-Respond)*.

Ministria e Punëve të Brendshme – AME (2023). *Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028*.

Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022). *Strategjia për Mjedis 2022–2031*.

natyrore, si mekanizëm për përmirësimin e qëndrueshmërisë klimatike në nivel lokal.
Marrë nga: <https://mmphi.rks-gov.net>

5. “Jemi gati me pastru, na jepni mjetet”

Formimi i ekipeve komunitare për mbikëqyrje mjedisore

Propozimi: Ngritje e grupeve aktive në monitorim të mbetjeve, ndotjes dhe vatrave zjarri, me pagë simbolike nga komunat (mund të gjinden edhe modalitete tjera bashkëfinancimi me organizatat zhvillimore në vend) dhe bashkëpunim me organet vendore.

Lidhja strategjike:⁸

UNDP Kosova (2024) thekson rëndësinë e angazhimit të komunitetit lokal në projektet për adaptim klimatik dhe siguri mjedisore, duke identifikuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve si kusht për ndërtimin e reziliencës.

Raporti CCDD i Bankës Botërore për Kosovën (2024) thekson se për të qenë efektiv planifikimi klimatik, duhet të mbështetet në pronësinë lokale dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje dhe mbikëqyrje.

Strategjia e Mjedisit 2022–2031 e Kosovës përmend nevojën për ndërtimin e mekanizmave të përfshirjes së komuniteteve në monitorim të ndotjes, menaxhimin e mbeturinave dhe të aseteve natyrore.

Strategjia për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028 thekson formimin e strukturave komunitare për reagim të shpejtë dhe bashkëpunim me institucionet për raportim të hershëm dhe reagim të koordinuar.

6. “Ndezim zjarre edhe pse e dimë se s’duhet”

Kushtëzimi i subvencioneve bujqësore me kushte mjedisore

Propozimi: Subvencionet bujqësore të jenë të lidhura me respektimin e masave të

⁸ **Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP Kosovë.** (2024). *Raporti për Ndikimin dhe Rezultatet në Mjedis dhe Klima 2023–2024*. Prishtinë: UNDP Kosovë.

Banka Botërore. (2024). *Raporti për Klimën dhe Zhvillimin në Kosovë (Country Climate and Development Report – CCDD)*. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore.

Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022).

Strategjia për Mjedis 2022–2031. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. (2023). *Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

mbrojtjes (rripa mbrojtës, ndalim djegieve, ruajtje e tokës). Monitorim me dron ose GPS sistem/satelit.

Lidhja strategjike:⁹

Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) i Kosovës 2025–2030 thekson nevojën për lidhjen e subvencioneve publike me kritere mjedisore, si instrument për të ndikuar sjelljet e sektorëve me ndikim të lartë në emetimet dhe degradimin e mjedisit.

UNDP Insight (2025) adreson mënyrën se si politikat bujqësore dhe fiskale mund të përdoren për të orientuar sjelljen e fermerëve drejt praktikave të qëndrueshme, duke përfshirë ndalimin e djegieve dhe mbrojtjen e tokës.

Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Kosovës 2022–2028 përfshin objektiva për të promovuar bujqësi të gjelbër dhe efçente përmes skemave të mbështetjes që stimulojnë prodhimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e ndikimit në mjedis.

Strategjia për Mjedis 2022–2031 kërkon harmonizimin e politikave ekonomike me qëllime ambientale, duke përfshirë vendosjen e standardeve ekologjike për të përfituar nga mbështetja publike dhe ndërkombëtare.

7. “OJQ-të s’na ftojnë”

Përfshirja gjithëpërfshirëse gjinore dhe rinore

Propozimi: Projekte që aplikojnë për fond publik të kenë strategji gjithëpërfshirëse gjinore dhe të rinjsh. Trajnime dhe përfaqësim i barabartë.

⁹ **Republika e Kosovës, Ministria e Ekonomisë.** (2023). *Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025–2030 (NECP)*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP Kosovë. (2025). *Insight Policy Report: Instrumente financiare për tranzicion të qëndrueshëm në sektorin bujqësor*. Prishtinë: UNDP Kosovë.

Republika e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. (2022). *Strategjia e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Ruralitetit 2022–2028*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022). *Strategjia për Mjedis 2022–2031*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Lidhja strategjike:¹⁰

UNDP Kosovë thekson përmes raporteve dhe projekt-propozimeve nevojën që planet klimatike të zbatohen qasje të ndjeshme gjinore dhe të përfshijnë vajzat dhe gratë në ndërtimin e reziliencës.

UNICEF Kosovë promovon përfshirjen e të rinjve në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme dhe të gatshme për sfida klimatike, përmes trajnimeve, aktivizmit dhe angazhimit institucional.

Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 13.3 (SDG 13.3) kërkon përmirësimin e edukimit, ndërgjegjësisë dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për të trajtuar ndikimet e ndryshimeve klimatike – me theks në përfshirje gjithëpërfshirëse.

Strategjia për Barazi Gjinore 2020–2024 e Kosovës parasheh përfshirjen e dimensionit gjinor në të gjitha politikat dhe programet, përfshirë ato që lidhen me klimën dhe ambientin, si pjesë e parimeve të qeverisjes gjithëpërfshirëse.

8. “Nëse kishim aplikacion...”

Zhvillimi i mjeteve digjitale për sinjalim

Propozimi: Komunitat të krijojnë aplikacione/sms për raportim emergjencash dhe ndotjeje, të mbështetura me një panel transparence online për qytetarët.

Lidhja strategjike:¹¹

NAXhenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor thekson rëndësinë e përdorimit të teknologjive të reja (aplikacione, platforma digjitale, sinjalizim në kohë reale) për të përmirësuar shërbimet publike dhe menaxhimin e krizave mjedisore dhe klimatike.

¹⁰ **Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP Kosovë.** (2024). *Programi i Reziliencës Komunitare dhe Përfshirjes Gjinore*. Prishtinë: UNDP Kosovë.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë – UNICEF Kosovë. (2023). *Raporti për të Rinj dhe Reziliencën ndaj Ndryshimeve Klimatike*. Prishtinë: UNICEF Kosovë.

Kombet e Bashkuara. (2015). *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: SDG 13.3*. New York: Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale i OKB-së.

Republika e Kosovës, Agjencia për Barazi Gjinore. (2020). *Strategjia për Barazi Gjinore 2020–2024*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

¹¹ **Komisioni Evropian.** (2020). *Axhenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor*. Bruksel: Komisioni Evropian – Drejtoria për Zgjerim dhe Politika të Fqinjësisë.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP. (2023). *Përshpejtimi i SDG-ve: Raporti mbi Ndërlidhjen e Politikave Klimatike dhe Transformimit Digjital*. New York: UNDP Global Policy Network.

Republika e Kosovës, Ministria e Ekonomisë. (2022). *Strategjia Kombëtare për Zhvillim të Shoqërisë Digjitale 2022–2026*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Republika e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. (2023). *Strategjia Shtetërore për Menaxhimin e Emergjencave 2023–2028*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

UNDP dhe SDG 13.2 promovojnë integrimin e ndryshimeve klimatike në politikat kombëtare, përfshirë zhvillimin e mekanizmave digjitalë për mbledhje të dhënash, transparencë dhe veprim institucional të koordinuar.

Strategjia Kombëtare për Shoqëri Digjitale 2022–2026 e Kosovës synon përmirësimin e qasjes qytetare në shërbimet digjitale dhe përfshirjen e teknologjisë në sektorët e sigurisë, mjedisit dhe emergjencave.

Strategjia për Menaxhimin e Emergjencave 2023–2028 mbështet zhvillimin e platformave për alarmim të hershëm dhe raportim nga qytetarët përmes kanaleve teknologjike si aplikacionet dhe sms-të.

9. “E kemi planin, por s’e ka lexuar askush”

Formalizimi i bashkëpunimit në hartimin e dokumenteve emergjente

Propozimi: Hartim protokollesh bashkëpunuese mes Komunës, Agjencisë së Emergjencave, Policisë dhe Agjencisë së Pyjeve; rishikim dhe ushtrime vjetore. Përfshirje buxhetore dhe grantesh.

Lidhja strategjike: ¹²

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Kosovës 2022–2027 thekson nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional vertikal dhe horizontal për reagimin ndaj krizave dhe rreziqeve klimatike.

NATO dhe partnerët e saj në Ballkanin Perëndimor promovojnë bashkëpunimin institucional në kuadër të sigurisë klimatike, veçanërisht në koordinimin ndërmjet strukturave civile dhe emergjente.

Raporti Ready-2-Respond i Bankës Botërore (2021) vlerëson rëndësinë e krijimit të kornizave ligjore dhe operative për bashkëpunim ndërmjet aktorëve lokalë dhe qendrorë në situata emergjente.

Strategjia për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028 e Kosovës identifikon mungesën e protokolleve të formalizuara si pengesë për përgjigje efikase në raste të rrezikut dhe kërkon përmirësim të sistemit të koordinimit institucional.

¹² **Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit.** (2022). *Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022–2027*.

Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut – NATO. (2023). *Raporti për Sigurinë Klimatike dhe Rritjen e Reziliencës në Ballkanin Perëndimor*. Bruksel: Divizioni për Çështje Politike dhe Siguri.

Banka Botërore & GFDRR. (2021). *Kosova – Raporti Diagnostik për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave (Ready-2-Respond)*. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore.

Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme – Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. (2023). *Strategjia për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2028*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

10. "I kemi grahë vetë, se s'ka kush tjetër"

Programet e përbashkëta të mirëmbajtjes së lumenjve/ujoreve

Propozimi: Komunat me Ministrinë e Mjedisit dhe Agjencinë e Ujërave të hartojnë plane vjetore për mirëmbajtje, pastrim dhe mbjellje bregore. Monitorim dhe financim të përbashkët.

Lidhja strategjike:¹³

Strategjia Kombëtare për Burimet Ujore në Kosovë vendos në qendër menaxhimin e integruar të baseneve ujore, përfshirjen ndërkomunale dhe planifikimin afatgjatë për ruajtjen e lumenjve dhe burimeve natyrore.

World Bank CCDD 2024 vlerëson se menaxhimi preventiv i ujërave, përmes pastrimit dhe monitorimit të shpeshtë, ul ndjeshëm rrezikun e përmytjeve, degradimit të tokës dhe krizave klimatike në komunitete vulnerabël.

Strategjia e Mjedisit 2022–2031 përmend mbrojtjen e ekosistemeve ujore si një prioritet horizontal që kërkon bashkëpunim institucional dhe ndërkomunal për të parandaluar ndotjen dhe shkatërrimin e shtratit të lumenjve.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Baseneve Lumore në Kosovë (2020) thekson nevojën për mirëmbajtje të rregullt të infrastrukturës ujore dhe për ndërhyrje parandaluese të koordinuara midis komunave dhe institucioneve qendrore.

11. "Objektet janë të vjetra... mungon trajnimi"

Përforcimi i njësive lokale të zjarrfikësve

Propozimi: Vendosje të njësive në çdo komunë, me autopajisje moderne, uniforma, trajnime dhe koordinim me Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Pyjeve. Financohet nga MFE dhe fonde ndërkombëtare.

¹³ Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (2017). *Strategjia Kombëtare për Ujërat 2017–2036*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Banka Botërore. (2024). *Raporti për Klimën dhe Zhvillimin në Kosovë (Country Climate and Development Report – CCDD)*. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore.

Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2022). *Strategjia për Mjedis 2022–2031*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Republika e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Ujërave. (2020). *Plani Kombëtar për Menaxhimin e Baseneve Lumore*. Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Lidhja strategjike:¹⁴

Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022–2027 thekson domosdoshmërinë për të përforcuar kapacitetet reaguese në rastet e emergjencave, përmes forcimit të strukturave operative, burimeve njerëzore dhe teknike në nivel lokal.

Raporti Ready-2-Respond i Bankës Botërore (2021) sugjeron ndërtimin e një sistemi të vlerësimit të nevojave për zjarrfikësit dhe strukturat emergjente komunale, si dhe përshtatjen e infrastrukturës dhe trajnimeve për menaxhim efikas.

UNICEF Kosovë adreson mungesën e kapaciteteve lokale për t'u përballur me katastrofa natyrore si barrë të drejtpërdrejtë mbi komunitetet e ndjeshme, sidomos fëmijët dhe grupet vulnerabël, duke sugjeruar ngritjen e infrastrukturës reaguese.

UNDP në Kosovë përmes projekteve të reziliencës lokale thekson nevojën për përgatitje teknike, koordinim ndër-institucional dhe investime të synuara në pajisje emergjente dhe burime njerëzore.

12. “Veç na trajnon dikush, e jemi gati me ndihmu”

Integrimi i vullnetarëve me strukturat e reagimit të parë

Propozimi: Të krijohet një program certifikimi për vullnetarë, me stërvitje, sigurim dhe pajisje bazë. Fëmijë dhe të rinj të përfshihen në përgatitje, në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit dhe Agjencinë për Menaxhim të Emergjencave.

Lidhja strategjike:¹⁵

UNICEF Kosovë thekson rëndësinë e përgatitjes së të rinjve dhe komuniteteve për të reaguar ndaj krizave përmes rrjeteve vullnetare të organizuara dhe të trajnuara, si një pjesë thelbësore e mbrojtjes së grupeve vulnerabël.

¹⁴ **Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit.** (2022). *Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022–2027*. **Banka Botërore & GFDRR.** (2021). *Kosova – Raporti Diagnostik për Gatishmërinë dhe Reagimin ndaj Emergjencave (Ready-2-Respond)*

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë – UNICEF Kosovë. (2023). *Përfshirja e Komuniteteve dhe Mbrojtja e Fëmijëve në Kriza Mjedisore dhe Klimatike.*

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP Kosovë. (2024). *Programi për Reziliencë Komunale dhe Siguri Klimatike.*

¹⁵ **Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë – UNICEF Kosovë.** (2023). *Rinia në Qendër të Reagimit: Angazhimi i Vullnetarëve në Kriza Klimatike.*

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP Kosovë. (2024). *Modeli i Reziliencës Gjithëpërfshirëse në Nivel Komunal.*

Banka Botërore. (2024). *Raporti për Klimën dhe Zhvillimin në Kosovë (Country Climate and Development Report – CCDR).*

Kombet e Bashkuara. (2015). *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: SDG 13 – Ndërmarrja e Veprimeve për Klimën.*

UNDP në Kosovë mbështet qasjen “whole-of-society” për përgatitje ndaj emergjencave, duke përfshirë vullnetarët dhe shoqërinë civile në plane veprimi dhe struktura reaguese lokale.

World Bank CCDR (2024) inkurajon vendosjen e mekanizmave për përfshirjen e komunitetit dhe vullnetarëve në monitorim, sinjalizim dhe menaxhim emergjent, si element kyç për reziliencë klimatike.

Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 13 (SDG 13) kërkon ndërtimin e kapaciteteve institucionale për përballimin e ndryshimeve klimatike dhe përfshirjen e komuniteteve në planifikimin dhe reagimin ndaj krizave.

Prishtinë 2025



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË
